

AKT THEMELIMI & STATUTI
i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar
“Immersive MA Sh.p.k.”

Sot, më datë 24/08/2023, ortakët e shoqërisë në themelimin e sipër **“Immersive MA” Sh.p.k.**

1. **Arbri Malile**, i biri i Drini Malile, shtetas Shqiptar, lindur në Tiranë, më 22/05/1984, mbajtës i letërnjoftimit me nr. 037257548 dhe nr. personal I40522114R
2. **Qemal Hasanbelli**, i biri i Baki Hasanbelli, shtetas Amerikan, lindur në Fier, më 31/05/1977, mbajtës i letërnjoftimit me nr. 588408467

Vendosin për themelimin e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar sipas legjislacionit shqiptar dhe në përputhje me dispozitat në vijim:

Neni 1

Themelimi

Shoqëria **“Immersive MA” Sh.p.k.** (këtu me poshtë e quajtur “Shoqëria”, ose **“IMA”**) themelohet si shoqëri me përgjegjësi të kufizuar sipas legjislacionit shqiptar. Shoqëria fiton personalitetin juridik me regjistrimin e saj në Regjistrin Tregtar Shqiptar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.

Neni 2

Selia

Selia e Shoqërisë ndodhet në adresën: RR.Shefqet Musaraj, Nd.14, H.4, Ap.5, Njësia Administrative Nr. 7, 1023, Tiranë, Shqipëri.

Shoqëria me vendim të Ortakëve mund të themelojë degë, zyra dhe vende pune në vende të ndryshme të Republikës së Shqipërisë si dhe jashtë saj, në përputhje me ligjet e zbatueshme dhe Statutin.

Neni 3

Objekti

Objekti i Shoqërisë është si më poshtë vijon:

1. Projekte dixhitale audiovizuale dhe produksione immersive arti dhe komerciale, dizajn dhe produksione filmike, marketing, inteligjencë artificiale dhe artet gjenerative.
2. Zhvillimi i koncerteve, eventeve, aktiviteteve muzeale dhe të trashëgimisë kulturore etj
3. Inovacioni, teknologjia dhe zhvillimi rajonal.

Objekti i aktivitetit të Shoqërisë mund të ndryshohet me vendim të ortakëve dhe mund të kryejë çdo lloj aktiviteti në përputhje me legjislacionin shqiptar.

Neni 4

Kohëzgjatja

Kohëzgjatja e Shoqërisë do të jetë për një periudhë kohore të pakufizuar, duke filluar nga data e regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

Neni 5

Kapitali Themeltar, Kontributi, Kuotat

1. Kapitali themeltar i shoqërisë është 100,000 Lekë. Kapitali themeltar është i ndarë në 2 (dy) kuota.
2. Kapitali themeltar zotërohet nga Ortakët si më poshtë:
 - **Arbri Malile**, zotëron 1 kuotë, me vlerë 70,000 Lek, që përbën 70% të kapitalit themeltar të shoqërisë.
 - **Qemal Hasanbelli**, zotëron 1 kuotë, me vlerë 30,000 Lek, që përbën 30% të kapitalit themeltar të shoqërisë
3. Përgjegjësia e Ortakëve shtrihet deri në vlerën e kontributit në kapitalin e Shoqërisë.

ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I SHOQËRISË

Neni 6

Organet e shoqërisë

Organet e shoqërisë janë Asambleja e Përgjithshme dhe Administratori.

Neni 7

Mbledhja dhe kompetencat e Asamblesë së Përgjithshme

Asambleja e Përgjithshme është organi më i lartë vendimmarrës i shoqërisë, dhe vendos për çdo çështje që ka të bëjë me shoqërinë, për te cilën në përputhje me Ligjin ose këtë Statut kërkohet vendim i Asamblesë dhe ky vendim është i detyrueshëm për të gjithë.

Asambleja e përgjithshme është kompetente të vendose për: 1) Ndryshimin e Statutit. 2) Emërimin dhe shkarkimin e Administratorit. 3) Për caktimin e shpërblimit të Administratorit. 4) Miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe Shpërndarjen e fitimeve vjetore 5) Riorganizimin dhe prishjen e Shoqërisë ose bashkimin e saj me shoqëri të tjera si dhe emërimin ose shkarkimin e Likuidatorit/ve. 6) Ngritjen e padive ndaj organeve të tjera të shoqërisë për dëmet që mund ti kenë shkaktuar asaj. 7) Zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit të regjistruar të Shoqërisë. 8) Për çdo çështje tjetër e cila në përputhje me dispozitat e Statutit ose Ligjit vendos Asambleja e Përgjithshme dhe nuk mund të vendosë Administratori.

Neni 8

Administrimi dhe përfaqësimi

Me këtë Statut caktohet administrator i shoqërisë, për një periudhe prej **5(pesë) vjet** prej datës se regjistrimit ne QKB, **z. Arbri Malile**, lindur në Tiranë, më 22/05/1984, mbajtës i letërnjoftimit me nr. 037257548 dhe nr. personal 140522114R.

Kompetencat e administratorit:

- a) të kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
- b) të përfaqësojë shoqërinë tregtare;
- c) të kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- ç) të përgatisë dhe nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
- d) të krijojë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- dh) të kryejë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
- e) të raportojë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
- ë) të kryejë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.

Administratori mund të autorizojë nëpërmjet një prokure apo autorizimi me afat të caktuar apo të pacaktuar, një person të tretë për të përfaqësuar Shoqërinë dhe për të nënshkruar çdo dokument, kërkesë ose aplikim në emër dhe për llogari të Shoqërisë në përputhje me kompetencat që ka në këtë statut.

VITI FINANCIAR – SHPËRNDARJA E FITIMEVE

Neni 9

Viti Financiar

Viti financiar fillon në 1 janar dhe përfundon në 31 dhjetor të çdo viti kalendarik. Përfundimisht, viti i parë financiar fillon me regjistrimin e Shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe përfundon me 31 dhjetor 2023.

Neni 10

Prishja dhe Likuidimi

Shoqëria priset:

- a) Me vendim të Asamblesë së Ortakëve.
- b) me hapjen e procedurave të falimentimit.
- c) me vendim gjykate.

Mënyra të tjera të parashikuara nga ligji në fuqi

DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

Neni 11


Për të gjitha çështjet që nuk parashikohen në këtë Statut do të zbatohen dispozitat përkatëse të legjislacionit shqiptar në lidhje me shoqëritë tregtare.

Për mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij statuti, në rast mos arritjes së një marrëveshje nga ana e ortakëve, atëherë për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve do të jetë kompetente Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Ky Statut nënshkruhet në 3 (tre) kopje origjinale, me të njëjtën vlerë secila.

ORTAKËT

Arbri Malile


(emër, mbiemër, firmë)

Qemal Hasanbelli

**Përfaqësuar me prokurë nga
Arbri Malile**


(emër, mbiemër, firmë)

A black and white copy of this document is not official.

State of Florida



Department of State

APOSTILLE

(Convention de La Haye du 5 octobre 1961)

1. Country: **United States of America**

This public document

2. has been signed by **ALBANA HILA**

3. acting in the capacity of **Notary Public of Florida**

4. bears the seal/stamp of **Notary Public, State of Florida**

Certified

5. at **Tallahassee, Florida**

6. the **Eighteenth day of July, A.D., 2023**

7. by **Secretary of State, State of Florida**

8. No. **2023-122225**

9. Seal/Stamp:



10. Signature:

Secretary of State

DSDE 99 (2/12)

This document contains a true watermark. Hold up to light to see "SAFE" and "VERIFY FIRST."

The word "VOID" appears when photocopied.

"State of Florida" appears in small letters across the face of this 8 1/2 x 11" document.

PROKURE E POSACME

Sot, me date 18 Korrik 2023, ne zyren time me adrese:

2140 Drew St, Suite O,
Clearwater, FL, 33765, U.S.A

Prane meje Noteres Albana Hila, u paraqit personalisht i perfaqesuari: Qemal Hasanbelli, i biri i Baki dhe Keze, i lindur me 31 Maj 1977 ne Fier, idendifikuar me DL # H251-702-77-191-0, me banim te perhershem ne USA ne adresen:

3029 Crest Dr
Clearwater, FL, 33759

Per identitetin e te cilit u sigurova pasi kontrollova dokumentacionin e tij dhe pasi konstatova se i ka te gjitha aftesite e ligjit, me kerkesen e tij i redaktova kete Prokure te Posacme si me poshte:

"Une Qemal Hasanbelli autorizoj Z. Arbri Malile, i lindur me 22 Maj 1984 ne Tirane, mbajtes i ID me numer personal I40522114R dhe numer leternjoftimi 037257548, te kryeje te gjitha veprimet e nevojshme procedurale dhe ligjore ne lidhje me celjen e nje kompanie te perbashket (SH.P.K) shoqeri me pergjegjesi te kufizuara) ku une do te jem partner i saj dhe ortak themelues me 30% te aksioneve si dhe nenshkrimin e dokumentave te nevojshme sipas legjistacionit ne fuqi te shtetit shqiptar.

I jap te drejte dhe fuqi te plote te kryej ne emer dhe per dobine time te gjitha veprimet e nevojshme per kete akt.

Te gjitha veprimet qe do te kryen prej perfaqesuesit tim te posacem, per sa me siper, une i quaj te drejta dhe te plota njesoj sikur te isha vet i pranishem".

Kjo Prokure u perpilua ne Clearwater, Florida, USA, dhe u nenshkrua me vullnetin e lire dhe te plote nga i perfaqsuari Qemal Hasanbelli prane meje Noteres, Albana Hila.


I perfaqesuari,

.....
Qemal Hasanbelli

STATE OF FLORIDA
PINELLAS COUNTY

Subscribed and sworn to before me, the Notary Public, in and for said County, this 18th day of July 2023 by Qemal Hasanbelli, DL # H251-702-77-191-0.

ALBANA HILA
NOTARY PUBLIC



Shteti i Floridës
Departamenti i Shtetit
APOSTILLE

(Konventa e La Haye datë 5 Tetor 1961)

1. Shteti: **Shtet e Bashkuara të Amerikës**
Ky dokument publik:
2. Është nënshkruar nga : **ALBANA HILA**
3. Nën cilësinë e tij si **Notere Publike e Floridës**
4. Mban vulën /pullën e **Noteres Publike të Floridës**
5. Në **Tallahassee, Florida**
6. Më **Tetëmbëdhjetë Korrik, A.D., 2023**
7. Nga **Sekretari i Shtetit, Shteti i Floridës**
8. Nr. **2023- 122225**
9. Vula /pulla
(vulë)
10. Nënshkrimi
(nënshkrim)
Sekretari i Shtetit

DSDE 99 (2/12)

SHTETI I FLORIDËS
QARKU PINELLAS

Nënshkruar dhe betuar përpara meje, Noterit Publik, në dhe për Qarkun e sipërpërmendur, sot më 18 Korrik 2023 nga Qemal Hasanbelli, DL # H251-702-77-191-0.

(nënshkrim)

ALBANA HILA
NOTER PUBLIK

ALBANA HILA
Komisioni im # HH 012907
SKADON: 21 Korrik 2024
Të lidhur përmes nënshkruesve noterialë publikë
(vulë e lagësht, pullë)

Yna Lajta



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË
DEGA VENDORE TIRANË
NOTER MARGENA U. ÇELA



V2023053120186081950

DATE 24/08/2023
NR REP 2979

VËRTETIM PËRKTHIMI

Sot, më datë 24/08/2023, para meje Noter MARGENA U. ÇELA, anëtar në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore TIRANË, me zyrë në adresën Astrit BALLUKU, u paraqit personalisht:

PËRKTHYES: Ina Kajtazi, atësia Gani, amësia Alma, shtetase Shqiptare, lindur në Tiranë dhe banues në TIRANË, me adresë Astrit Balluku; Nd. 7; H. 1; Njësia Administrative Nr. 7; Njësia Bashkiake Nr. 7; 1023; Tiranë, lindur më 19/10/1986, gjendja civile “beqare”, madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të ciles u garantova me Leternjoftim ID nr. 034548672 dhe nr. personal I66019043M.

Përkthyesi është i licencuar nga Ministria e Drejtësisë, i cili/a më deklaroi se përktheu me përpikmëri dhe saktësi dokumentin bashkangjitur “Apostile nr. 2023-12225”, nga gjuha Anglisht në gjuhën Shqip dhe e nënshkroi rregullisht përpara meje Noterit.

Në referim të nenit 135, i ligjit nr. 110, datë 20.12.2018 “Për Noterinë”, në Republikën e Shqipërisë unë Noteri vërtetohet nënshkrimi i përkthyeses.

Në zbatim të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave Personale”, unë Noteri deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjekteve të këtij veprimi, në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

NOTER

MARGENA U. ÇELA

